



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1187/4 Prot

Tiranë, më 29/7/2021

VENDIM

Nr. 34, datë 29.7.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1187 Prot., datë 09.07.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë” (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet e-mail-it datë 26.05.2021, drejtuar Institutit të Shëndetit Publik, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

- *Kopje të analizave të ujit të pijshëm të Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë për periudhën 01.01.2020 e në vazhdim.*

Me e-mail-in datë 10.06.2021 koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Institutit të Shëndetit Publik, ka vënë në dispozicion shkresën nr. 659/2 Prot., datë 10.06.2021, si dhe ka deleguar kërkesën për informacion pranë autoriteteve publike kompetente, konkretisht, Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vijim, “OSHKSH”) dhe Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, me arsyetimin se objekti i kërkesës nuk është kompetencë e Institutit të Shëndetit Publik.

Të njëjtën procedurë ka ndjekur edhe koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Drejtorisë Qendrore të OSHKSH-së, e cila me e-mail-in datë 17.06.2021, drejtuar Njesisë

Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, ka kërkuar kthimin e përgjigjes për subjektin kërkuar duke vënë në dijeni edhe Drejtorinë Qendrore të OSHKSH-së.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, me e-mail-in datë 18.06.2021, i ka bërë me dije kërkuar se, sipas procedurave juridike dhe administrative, si dhe shkresës së Institutit të Shëndetit Publik, ku, *Qendra "Res Publica" informohet se duhet t'i drejtohet Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, duhet të vijohet me kërkesë për informacion pranë këtij të fundit.*

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, argumenton se: *"Arsyetimi i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, është i gabuar dhe i pambështetur në ligj. Në nenin 12 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", parashikohet se: "...2. Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuar. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar". Në rastin konkret, në zbatim dhe të dispozitave ligjore, kërkesa për informacion i është përcjellë autoritetit kompetent i cili disponon informacionin, pra Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë. Për sa kohë që ky institucion është vënë në dijeni të kërkesës, nuk ka arsye të ripërsëritjes së saj".*

Në vijim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, Komisioneri, me shkresën nr. 1187/1 prot., datë 14.07.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar kërkesën për informacion, brenda datës 21.07.2021.

Drejtoria Qendrore OSHKSH, me shkresën nr. 2000/1 Prot., datë 19.07.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1187/3 Prot., datë 26.07.2021, ka kërkuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë që brenda afatit të vendosur në shkresën nr.1187/1Prot., datë 14.07.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, t'i vërë në dispozicion Qendrës "Res Publica" informacionin që disponon referuar kërkesës.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, me shkresën nr. 1807/1 Prot., datë 21.07.2021, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me shkresën nr. 1187/2 Prot., datë

26.07.2021 ka kthyer përgjigje duke argumentuar se: “...Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm””, ku në pikën 3 dhe 5 është përcaktuar qartë se kujt i jepen këto informacione (sensitive). Pika 3. Për çdo monitorim, struktura rajonale e shëndetit publik harton raportin e monitorimit dhe në rast të konstatimit të parregullsive, jep rekomandime për administratorin e objektit të kontrolluar. Struktura rajonale e shëndetit publik i dërgon nga 1 (një) kopje të raportit të monitorimit administratorit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ISHSH-së rajonale. Pika 5. Rezultatet e këtij monitorimi regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-në rajonale, kur kërkohen prej tyre.”

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik dhe argumenti i dhënë për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndron.

Vlerësohet se, qëllimi i ligjit nr. 10 138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, i ndryshuar, është mbrojtja e shëndetit dhe promovimi i jetesës së shëndetshme të popullatës në Republikën e Shqipërisë, përmes veprimeve të organizuara, ndikimi i të cilave shpërndahet, në mënyrë të barabartë, në të gjithë grupet e popullatës.

Të njëjtin qëllim ka edhe Rregullorja “Cilësia e Ujit të Pijshëm”, miratuar me VKM-në nr. 379, datë 25.05.2016 “, mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së ujit, duke siguruar që uji është i shëndetshëm dhe i pastër. Në këtë kuptim, një nga mënyrat e arritjes së këtij qëllimi është dhe informimi, i cili parashikohet në nenin 26 të kësaj rregulloreje, përkatësisht në pikën 1, ku përcaktohet se: “1. Informacioni i dhënë përdoruesve duhet të jetë i besueshëm, i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i përditësuar në çdo aspekt të përshkruar në këtë rregullore, përmes çdo mjeti të mundshëm komunikimi nga secili autoritet kompetent i përfshirë dhe nga administratorët.”

Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 21 të VKM-së nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm””, parashikohet se: “1. Monitorimi i jashtëm është nën përgjegjësinë e strukturës rajonale të shëndetit publik, për të siguruar që uji i pijshëm në territorin e vet administrativ plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje”, në këtë kuptim, struktura rajonale është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Ndërkohë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me shkresën nr. 1807/1 Prot., datë 21.07.2021, citon se është përcaktuar qartë se kujt i jepen këto informacione (sensitive), pasi, bazuar në pikën 3 dhe 5 të VKM-së së sipërcituar, parashikohet se: “3. Për çdo monitorim, struktura rajonale e shëndetit publik harton raportin e monitorimit dhe në rast të konstatimit të parregullsive, jep rekomandime për administratorin e objektit të kontrolluar. Struktura rajonale e shëndetit publik i dërgon nga 1 (një) kopje të raportit të monitorimit administratorit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-së rajonale... 5. Rezultatet e këtij monitorimi regjistrohen në një regjistër dhe ruhen për të paktën 5 vjet. Ato vihen në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ISHSH-në rajonale, kur kërkohen prej tyre...”, duke refuzuar me këto argumente vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri vlerëson se dispozitat e cituara nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, për refuzimin e dhënies së dokumentacionit, nuk janë të zbatueshme në rastin konkret. Dhënia e informacionit për strukturat përkatëse kryhet në një kontekst të caktuar siç është rasti i detyrës funksionale në kuadër të veprimtarisë që ky autoritet ushtron, por, në asnjë rast nuk citon ndalimin e dhënies së informacionit për subjekte të tjera.

Gjithashtu, në pikat 2 dhe 3 të nenit 26 të VKM-së nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm””, parashikohet se: “2. Me qëllim informimin e konsumatorëve: a) Strukturat rajonale të shëndetit publik përgatisin raportin vjetor mbi cilësinë e ujit të pijshëm në rajonin e tyre; b) Instituti i Shëndetit Publik përgatit raportin vjetor kombëtar mbi cilësinë e ujit të pijshëm; c) Ministria e Shëndetësisë përgatit raportin trevjeçar mbi cilësinë e ujit të pijshëm. 3. Raportet sipas pikës 2 (“a” dhe “b”) botohen në faqen e internetit të institucionit përkatës brenda muajit të parë të vitit. Raporti i parë do t’i referohet vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje”.

Lidhur me argumentin e Njësies Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë se informacioni i kërkuar përmban të dhëna sensitive, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron, pasi “të dhëna sensitive”, në kuptim të pikës 4 të nenit 3 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Ndërkohë, kërkesa për informacion konsiston në vënien në dispozicion të kopjeve të analizave të ujit të pijshëm të Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë, të cilat nuk përmbajnë elementë të përfshira në parashikimin si më sipër por përbëjnë një interes për publikun.

Komisioneri vlerëson se LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Ligji për të drejtën e informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, nr. 1187 Prot., datë 09.07.2021, ndaj Autoritetit Publik “Operatori i Shërbimeve të kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 26.05.2021, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht:
 - Kopje të analizave të ujit të pijshëm të Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë për periudhën 01.01.2020 e në vazhdim, brenda datës 05.05.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 29.7.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

